

**Njoftim i përqendrimit me të cilin DOLIT INVESTMENTS A.D., Greqi do të fitoj kontrollin mbi
PAVLIDIS A.D. MERMER – GRANIT, Greqi**

(lënda nr. 08-22/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 24.01.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin DOLIT INVESTMENTS A.D. E THEMELUR NGA NJË PERSON, me seli në Bulevardin Pentelis nr. 103, Çalandri, 152 34, Atiki, Greqi do të fitoj kontrollin mbi PAVLIDIS AD. MERMER - GRANIT, me seli në Zonën Industriale Drama, kodi postar 66100, Greqi.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

DOLIT INVESTMENTS A.D. E THEMELUR NGA NJË PERSON (DOLIT INVESTMENTS SINGLE MEMBER S.A.) është një shoqëri e regjistruar në Republikën Helenike (Greqi), aktiviteti kryesor i së cilës është investimi në shoqëri tregtare të vogla dhe të mesme që operojnë në sektorin e burimeve natyrore, energjetikë dhe burimeve minerale. Blerësi është pjesë e ECM Group, ku si shoqëria udhëheqëse (holding) është shoqëria ECM Partners Inc. (ECM Partners Inc), një shoqëri e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, e cila merret me menaxhimin e investimeve, menaxhimin e fondeve dhe menaxhimin e rrezikut të investimeve, dhe është një nga pjesëmarrësit e parë dhe më të mëdhenj në këtë treg në territorin e Evropës Qendrore dhe Juglindore.

Para realizimit të Transaksionit, blerësi nuk është i pranishëm drejtpërdrejt ose tërthorazi në tregun e Maqedonisë.

PAVLIDIS A.D. MERMER - GRANIT (PAVLIDIS S.A. MARBLE – GRANITE) është themeluar si një shoqëri Holding, shoqëritë bijë të së cilës janë të fokusuara në aktivitete biznesi në fushën e burimeve minerale. Shoqëria e synuar, gjegjësisht shoqëritë e grupit të saj, janë të angazhuara në shfrytëzimin, prodhimin dhe shitjen e mermerit (kryesisht i bardhë), granitit dhe kuarcit. Një pjesë më e vogël e aktivitetit të Shoqërisë së synuar si Grup në vitet e fundit përfshin aktivitete biznesi që lidhen me burimet rinovuese të energjisë.

Shoqëria e synuar është e pranishme në tregun e Maqedonisë përmes shoqërisë së varur = Shoqëria aksionare për prodhim, përpunim, tregtim dhe montim të gurit dekorativ MERMEREN KOMBINAT SHA Prilep, me seli në ul. Lece Koteski nr. 60A në Prilep dhe EMBS 4058615. Aktiviteti prioritar i MERMEREN KOMBINAT SHA Prilep është 08.11 – Nxjerrja e gurit dekorativ dhe gurit për ndërtim, gëlqeror, gips të papërpunuar, shkumës dhe rrasa, dhe kompania në thelb merret me eksploatimin, prodhimin dhe shitjen e mermerit dhe produkteve të mermerit.

Përpara zbatimit të përqendrimit të planifikuar, Shoqëria e synuar kontrollohet bashkërisht nga disa persona fizikë. Me transaksionin në fjalë, Blerësi do të fitoj 100% të aksioneve në Shoqërinë e synuar, duke ushtruar kështu kontroll të pavarur të drejtpërdrejtë mbi të njëjtën.

Parashtruesi propozon që si treg relevant i mallrave të konsiderohet **tregu i eksploatimit dhe shitjes së gurit dekorativ-mermerit** ndërsa **tregu i Republikës së Maqedonisë** së Veriut duhet të trajtohet si treg relevant gjeografik.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

27.01.2023

Shkup